



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA ADMINISTRATIVE E SHKALLËS SË PARË TIRANË

Nr. 8847/1 Prot.

Tiranë, më 19.07.2023

Lënda: Njoftim mbi përfundimin e procedurës së rekrutimit në “lëvizjen paralele” në kategorinë drejtuese Drejtor i Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar.

Drejtuar: **KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

Për dijëni: **znj. Etleva Gjamo, anëtare e Këshillit të Gjykatës.**

Të nderuar!

Në zbatim të ligjit 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, akteve ligjore të Këshillit të Lartë Gjyqësor lidhur me procedurat e rekrutimit të nëpunësve civil gjyqësor në gjykata, vendimit nr.622, datë 10.12.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor " dhe udhëzimit nr. 85, datë 11.03.2021 si dhe referuar shpalljes për konkurrim nr. 8847 prot., datë 04.07.2023 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, **ju njoftojmë se:**

Në përfundim të afatit të verifikimit paraprak në lidhje me procedurën e lëvizjes paralele në kategorinë drejtuese Drejtor i Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar, nuk u paraqit asnjë kandidaturë kualifikuese.

Në kushtet kur vendi vakanti për kategorinë drejtuese në shërbimin civil gjyqësor Drejtor i Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar, nuk plotësohet sipas procedurës së lëvizjes paralele, vijohet me procedurën e ngritjes në detyrë nga një kategori më e ulët në një kategori më të lartë.

Ky njoftim për shkak të respektimit të afateve në këtë procedurë, i përcillet vetëm anëtarit të Këshillit të Gjykatës znj. Etleva Gjamo, për shkak se deri më datë 19.07.2023 nuk është krijuar Këshilli i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Ju falenderojmë për bashkëpunimin!

KANCELARË
MARSIDA JANI

